



Republika e Kosovës

Republika Kosovo/Republic of Kosovo

Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH



Në bazë të nenit 12 pika d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-2008/28), neni 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL, neni 32 i Statutit të Komunës së Dragashit 01 Nr.06-103/1 i dt. 11.09.2008, në seancën e I-rë të Kuvendit të Komunës së Dragashit e mbajtur me dt. 27.01.2026, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miratohet:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSB)

Neni I

THEMELOHET Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Dragashit (KKSB), me këtë përbërje:

1. Bexhet Xheladini, kryetar i Komunës së Dragash-it (kryesues i Këshillit, sipas funksionit),
2. Shaqir Uka – komandant i Stacionit Policor në Dragash,
3. Sahit Hoti – komandant i Stacionit Policor për mbikëqyrje të kufirit në Dragash,
4. Xhafer Fejziu – përfaqësues i KBI Islame – Dragash,
5. Munafis Hodža - përfaqësues i KBI Islame – Dragash (Gora),
6. Anesa Mehmeti - përfaqësuese e komunitetit Shqiptarë,
7. Muamer Sulejmani – përfaqësues i komunitetit Goranë,
8. Miralem Rahte - përfaqësues i komunitetit Boshnjakë,
9. _____ – kryesuesi/ja e Komitetit për Komunitete,
10. Lindita Piraj- zyrtare për barazi gjinore në komunën e Dragashit,
11. Zeni Krasniqi – drejtor i DKA-së në Dragash,
12. Reshat Ajdini – Këshilli i Prindërve të DKA-së në Dragash,
13. Vedat Shatri – përfaqësues i FSK-së,
14. Behar Brenoli – përfaqësues i KLSP – Krushevë,
15. Raisa Šabani - Jelmazi -Drejtoresh e Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbimeve Publike – Dragash,
16. Uzair Hamza – përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
17. Suad Tosuni, OJQ ‘‘Renesansa’’ – Dragash,

Neni II

Anëtarët e këtij këshilli (përfshirë edhe koordinatorin Adem Emini) kanë mandatin e njëjtë sikurse delegatet e Kuvendit të Komunës dhe për punën e tyre paguhen, për vetëm 6 takime të Këshillit brenda vitit kalendarik, nga buxheti i Komunës, sipas shumës ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete.

Neni III

Në rast të mungesës së Kryesuesit të KKS-së në ndonjë takim pune, takimin e kryeson Nënkryetari i Komunës.

Neni IV

Për implementimin e këtij Vendimi përkujdesen kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa, Ekonomi e Zhvillim në Dragash.

Neni V

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KKS-së, organizimi i mbledhjeve, vendimmarrja, si dhe mbikëqyrja e punës së KKS-së, janë të rregulluara me Udhëzimin Administrativ nr.27/2012 MPB-03/2012, për Këshillat Komunal në Siguri në Bashkësi.

Neni VI

Vendimi, hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8 dhe nenit 9 të Ligjit Nr.08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 24/2024'' dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

I dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Dragash-it z.Bexhet Xheladini
- Anëtarëve të KKS-së,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore) – Prishtinë dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS - DRAGASH

01 Nr. 060/01-934-5126

Dt. 27.01.2026

Kryesuesi i Kuvendit:

Resul Fetahu

